



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
DREJTORIA JURIDIKE, PROKURIMEVE DHE PRONAVE  
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - VENDIM

Nr. 10, datë, 23.10.2024

**“PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, QË NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, pikat 1 dhe 2, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 15, pika 5 të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18240/2 Prot., datë 31/10/2023, “Për vlerësimin e nivelit të të ardhurave mesatare të familjeve”, me propozimin të Kryetarit të Bashkisë, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024,

PROPOZON

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë për individët/ familjet, sipas listës së përfituesve, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij projekt-vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë deri më Janar 2025, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Për individët/familjet, e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pagesave do të realizohet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit, pranë Drejtorisë Ekonomike.
4. Ngarkohen Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

**Përgjegjës i Sektori të  
Administrimit të Pronave  
dhe Strehimit**  
Gazmend Miftari

**Drejtori Juridik**

Ismet Saraçi

**KRYETARI I BASHKISË  
RAHIM SPAHIU**



**Tabela nr. 4 Llogaritja e masës së subvencionimit të qirasë**

Nr	Emër, Atësia, Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018, i ndryshuar	Përbërja familjare	Struktura e apart.	Sipërfaqja e apart.	Qiraja mes. e apart. në treg për strukturën që i takon familjes	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas pikës 45, e nenit 2, të ligjit 22/2018, i ndryshuar)	Aftësia përballues e sipas nenit 3 të ligjit	Qiraja e përballu eshme (h*j)	Subvencioni në muaj	Subvencioni në muaj që mbulohe t nga bashkia	Shuma që kerkohet nga buxheti
											(g-k)		(l-m)
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Edlira Besim Çutra	PAK	1	Garsionerë	50	6,000	0	“ç”	0	0	6,000	6,000	0
2	Ervina Mehmet Mani	Familje një prindërore	4	1+1	50	12,000	35,500	“c”	15%	5,325	6,675	6,675	0
3	Kadri Mehmet Ajazi	PAK	7	2+1	77	15,000	0	“ç”	0	0	15,000	15,000	0

Mbyllur me numër rendor 3 (tre)

Date 13/10 /2024

**RELACION**  
**PER PROJEKT VENDIMIN**  
**PËR**  
**“ TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI ”**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, Vendimin nr. 814, datë 03.12.2004, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr. 1093 date 28.12.2015 “ Per miratimin e procedurave, kritereve dhe perparësive per dhenien e bonusit te strehimit” i ndryshuar, VKM Nr. 362\_date 29.05.2019\_Per kriteret e dhenies se subvencionit te qirase per kategorie qe gezojne perparesi ne subvencionimin e qirase ne tregun e lire, shkreses nr. 747 prot date 12.01.2024 mbi fondet per programet e strehimit 2024 , referuar dokumentacionit te paraqitur ne sektorin e administrimit te pronave dhe strehimit aplikuesit per tu trajtuar me bonus te qerases sipas tabelës nr. 4 pershihen ne kategorie prioritare, sipas nenit 16 te ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, i ndryshuar.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin.

Per zypren e pronave dhe strehimit

Specialist

Mentor Bitri



Jurist

Xhesika Rama



Pergjegjes

Gazmend Miftari

